

Komunikimi politik nëpërmjet editorialit në gazetën "Koha jonë" (1997)

*Valmora Gogo**

Abstrakti

Komunikimi politik nëpërmjet editorialit në gazetën "Koha Jonë" (1997)

Studimi do të synojë të thellohet mbi komunikimin politik dhe mesazhin që ka shkuar tek lexuesi, nëpërmjet editorialit në gazetën "Koha Jonë" gjatë periudhës shkurt-mars 1997.

Qëllim i rëndësishëm do të jetë kuptimi i rolit të medias për komunikimin e ideve politike në masë tek publiku, duke ditur impaktin që kjo gazetë ka patur asokohe në publikun e Shqipërisë. Mendoj të realizoj një analizë të hollësishme të këtij lloji artikulli gazetaresk, lidhur edhe me stilistikën, tonin, figuracionin etj.

Po kështu do synoj të sjell rolin e editorialit si katalizator i zhvillimeve politike, duke qenë se hipoteza kryesore do të jetë kjo.

Përveç analizës së mesazhit (editorialit) kam për qëllim të bëj edhe një analizë të autorit të mesazhit (botuesi, drejtori i gazetës ose kryeredaktori) dhe lidhjes me të qenit një komunikues politik, duke marrë edhe rolin e një "partie politike". Për këtë analizë mendoj të shfrytëzoj literaturën e teorive të komunikimit politik, përveç punës me monitorimin e gazetës për këtë periudhë.

Gazeta "Koha Jonë" e vitit 1997 mund të shenjojë një nga periudhat e fundit në Shqipëri për lulëzimin e medieve lineare, vend që e zunë më pas me kalimin e viteve mediet e reja.

Fjalë kyce: *Komunikimi politik në gazetë, Editoriali në gazetë, Editoriali dhe Komunikimi politik, Editoriali dhe politika, Editoriali te "Koha Jonë"*

Hyrje

Gazeta "Koha Jonë", ka luajtur një rol të rëndësishëm në historinë e shtypit shqiptar në Shqipëri. Krijuar që prej 11 majit të 1991-shit, kjo gazetë 6 vjet më vonë pati një rol të pazëvendësueshëm për lexuesin shqiptar, duke u bërë paraprijëse por edhe nxitëse e zhvillimeve

* Valmora Gogo, Kandidat për Doktor, Newsbomb.al, valmoragogo@gmail.com

politike në Shqipëri. Me një rol jo krejtësisht të paanshëm, gazeta u bë palë me publikun, të cilin e mendonte të afërt me politikën editoriale që kishte, duke kundërshtuar fuqishëm partinë që sundonte sistemin politik të kohës, në krye të së cilës ishte Sali Berisha.

Zhvillimet nuk po dukeshin krejt të qeta për Shqipërinë e '97. "Koha Jonë" po paralajmëronte zhvillime aspak të mira për vendin, që në fakt rezultuan me trazira e përplasje me armë, skemat piramidale po binin¹, depot e armatimeve në gjithë vendin po hapeshin dhe sigurisht që "Koha Jonë", e vetmja gazetë me ndikim në opinionin publik se informonte saktë, po lobonte fort në largimin e qeverisë.

Hipoteza

Hipoteza kryesore e këtij studimi ka të bëjë me vërtetimin e rolit opozitar të "Koha Jonë", jo vetëm kritik e të paanshëm, duke marrë herë pas here rolin e një "partie politike". Në fund të tij do të renditen edhe disa nga gjetjet kryesore të analizës së editorialeve gjatë muajit shkurt-mars 1997.

Tranzicioni në Shqipëri dukej se nuk po përfundonte, madje po shfaqte tregues të hapave pas në këtë proces që prekën të gjitha vendet postkomuniste².

"KJ" lidhet me politikën nëpërmjet editorialit, reklama dhe PR-i politik nuk ishte zhvilluar plotësisht³. "Mediat dhe në veçanti mediat e shkruara-janë të rëndësishme në procesin politik në mënyrë më direkte. Ndonëse analistët mund të diskutojnë rreth anësive të reportazhit, të gjitha gazetat krenohen me "zërin e tyre publik"-editorialet, ku ata artikulojnë opinionet politike. Shpesh këto prezantohen si "zëri i lexuesve" dhe u drejtohen politik-bërësve. Në mënyrë alternative ato mund të hartohen si zëri i qetë, autoritar i kryeredaktorit, duke e parë skenën politike nga njëfarë distance. Në të

¹ Shënim: Fondacionet ku shqiptarët hidhnin kursimet e tyre në para për të marrë trefishin e tyre, brenda 3 muajsh

² Fatos Tarifa, *Paradigma e tranzicionit demokratik: "Fundit" i tranzicionit apo një tranzicion pa fund*, Tiranë, Ombra GVG, 2009, Fq.47-77

³ Brian McNair, *Hyrje në komunikimin politik*, Tiranë, UET Press, 2009, Fq.26

dyja rastet editoriali nënkupton një ndërhyrje politike dhe shpesh lexohet si i tillë nga një qeveri ose një parti"⁴.

Shtypi me politikën lidhet sipas McNair edhe tek editoriali : "1-Editoriali 2-Gazetari ekspert 3-Rubrika ose analiza(OP-ED) 4-Kryeartikulli 5-Rapsodët(humor, satirë, ironi, karikaturë, 6-Intervista politike 7-Ekspertët e politikës" dhe "...shtypi ka forma më 'autoritare' të ndërhyrjes në politikë. 'Zëri' më i rëndësishëm i një gazete është editoriali saj, i cili personifikon identitetin e saj politik...Editoriali kërkon të artikulojë atë që botuesit e gazetës besojnë se është zëri kolektiv i lexuesve të saj"⁵

Historiku i gazetës "Koha Jonë"

"Koha Jonë" kapi majat e ndikimit para trazirave të '97. Kishte një tirazh mbi 40 mijë kopje në ditë, për numrin e së cilët lexuesi qëndronte në radhë. Botuesi i saj ishte Nikollë Lesi, ndërsa editorialet shkruheshin në dy forma, ose të firmosur në fund "Koha Jonë", që tregonte se ishin krijuar nga redaksia e gazetës, ose në formën tjetër me emrin e autorëve⁶ si Vladimir Prela, Frrok Çupi, Skënder Minxhozi, Blendi Fevziu, Martin Leka etj. Edhe në rastin kur artikujt shoqëroheshin me emra autorësh, ata ishin në të njëjtin pozicion të gazetës. Gazeta e kësaj periudhe ishte 24 faqe, e përditshme dhe të hënën nuk dilte në treg. Ishte një format më i vogël në përmasa se "Rilindja Demokratike" dhe "Zëri i Popullit". Vetshpallej "E pavarur".

Shkrimet publikoheshin në radhën: Kryeartikull me Titull, Nëntitull, Mbititull, foto e madhe zhvendosur djathtas. Editoriali publikohej me titullin në bold majtas dhe kryesisht i firmosur "K.J" në fund. Kishte tituj më të vegjël në pjesën fundore të faqes së parë. Rubrika të tjera ishin: Speciale, Politikë(2 fq.), Ekonomi (2fq.),

⁴ Brian McNair, *Hyrje në komunikimin politik*, Tiranë, UET Press, 2009, Fq.66

⁵ Brian McNair, *Hyrje në komunikimin politik*, Tiranë, UET Press, 2009, Fq.83-84

⁶ Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimin publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.207

Reklamë (5fq.), Kronikë (2fq.), Të jashtme(2fq). Kulturë(3fq.), Histori (1fq), Sport (2fq), Fjalëfryq (1fq).

Gjatë muajit shkurt editorialet ishin thuajse të përditshme dhe ishin të gjitha të lidhura me zhvillimet politike në vend dhe me sulmet që u bëheshin gazetarëve. Tituj kryesorë ishin: "Piramidat e harruara", "Sa para kanë fondacionet", "Koha Jonë" në burg", "Deri në qindarkën e fundit...", "Millosheviçi dorëzohet, Berisha ende jo", "Tani koha për politikë" Vladimir Prela, "Pse nuk po çahet blloku?" Frrok Çupi, "Mbroni gazetarët nga shteti", "2 prilli i PD-së" "Vrasjet-tragjedia duhej të evitohet" Skënder Minxhozi, "Doktor, ky është fundi!" 'Aleksandri i 'vogël' kërkon luftë" Frrok Çupi, "Qeveri jashtë globit" Frrok Çupi, "Presidenti, asgjë të re për të thënë" Skënder Minxhozi, "PD-ja e rrethuar" Vladimir Prela, "Dialogu i Pamundur" Skënder Minxhozi "20 shkurti na gjeti në rrugë" Blendi Fevziu, "Ultimatumi Evropian" Skënder Minxhozi, "VEFA dhe politika shqiptare" dhe "Zonat e lira nuk zgjedhin Berishën" Martin Leka.

Pozicioni i saj në treg ishte falë qëndrimit të saj politik, ashtu siç e konstatojnë edhe studiuesit Hamit Boriçi dhe Mark Marku⁷. Pikërisht në këtë periudhë "Koha Jonë" forcon "luftën", si një opozitë e vërtetë, nëpërmjet rolit të saj, që ia kishte lejuar vetes, ndryshe nga çfarë ndodh me një media të zakonshme.⁸

⁷ Hamit, Boriçi, Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar. Nga fillimet deri në ditët tona*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2010, fq.270

⁸ Shenim: "Pas marsit të vitit 1992 "Koha Jonë" u bë gazeta kryesore në vend dhe fitoi autoritet publick pasi mori përsipër t'i bënte oponentë të fortë qeverisë demokratike të Sali Berishës, që sapo kish dalë nga zgjedhjet e 22 marsit 1992. Në fillim gazeta u bë e njohur nëpërmjet shkrimeve të kundërshtarëve politikë të presidentit Berisha të larguar nga Partia Demokratike, duke denoncuar prirjet autoritare të drejtimit të partisë nga ana e Berishës. Natyrisht krijimi i një hapësire të tillë për kundërshtarët e Berishës e ligjëroi atë si opozitë e pushtetit dhe ky pozicion ishte aq domethënës, sa në opinion mendohej që opozita e vërtetë e pushtetit ishte gazeta "Koha Jonë" dhe jo Partia Socialiste, forca kryesore politike opozitare e Parlamentit Shqiptar. Shumë shpejt në sajë të këtij pozicioni, gazeta mbledhi rreth vetes personalitetet kryesore publike të majtë të vendit, të cilët filluan t'i botonin shkrimet dhe artikujt e tyre tek "Koha Jonë". "Nga ana e saj "Koha Jonë" ishte rrallë herë profesionale në akuzat ndaj qeverisë

"KJ" pati luksin të sillej në këtë formë, për shkak të zhvillimeve që po ndodhnin në vend, ku kishte shumë ngjarje për t'u raportuar e shumë të tilla për të qenë kritike. "Fronti ballor i luftës" qenë editorialet.⁹

Analiza e editorialit të "Koha Jonë"

Editoriali ishte i qartë në gazetë. Pozicionuar gjithnjë majtas në faqen e parë¹⁰, me të njëjtën gjatësi thuhet një-kollonëshe. Editorialet ishin politike, me autor kryesisht redaksinë. Artan Fuga e klasifikon gazetën si të pavarur me natyrë politike dhe gazetë e "shanceve të barabarta"¹¹. Siç e shpjegon edhe Hamit Boriçi përmbajtja e editorialit shpreh karakterin relativ të pavarësisë së gazetës¹². Editorialet në gazetën "Koha Jonë" të kësaj periudhe mund të konsiderohen fare

dhe në shumicën e rasteve edhe abusive. Kulmin e vet ajo e pati gjatë viteve 1996-1997 për shkak të ndikimit të madh që kishte në public, sidomos në ato shtresa të popullsisë që ishin të orientuara politikisht nga e Majta", Hamit, Boriçi, Mark Marku, *Histori e shtypit shqiptar. Nga fillimet deri në ditët tona, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2010, fq.274-275*

⁹ Shenim:Editoriali karakterizohet si -një artikull gazetaresk-shkrimi kryesor i gazetës së ditës apo i revistës së një numri të caktuar-që shkruhet- nga botuesi (editori), nga titullari i gazetës ose me orientim, me leje e miratim të tyre, që shpreh një qëndrim, përhap (propagandon) një opinion të caktuar për një prej çështjeve të rëndësishme të ditës. Si artikull gazetaresk, afron me kryeartikullin, por është tjetër soj. Autorësia si e drejtë e patjetërsueshme është e botuesit, është veçori e editorialit. Realisht editorialin e ideon botuesi, ai që e financon (subvencionon) gazetën apo e ka licencën, por e shkruan një prej gazetarëve të stafit drejtues", Hamit Boriçi, , *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimin publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, fq.206

¹⁰ Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimin publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.209

¹¹ Artan Fuga, *Media, politika, shoqëria (1990-2000). Ikja nga kompleksi i Rozafës*, Tiranë, Botimet Dudaj, 2008, fq. 89, fq.141

¹² Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimin publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.206.

mirë të nënlojit operativë dhe të përgjithshëm politikë, shpesh të kombinuar me njëri –tjetrin.¹³

Duke e lidhur me faktin e suksesit të shitjes së gazetës, prej 40 mijë kopjesh në ditë, kur tirazhet e ditëve të sotme të gazetave kryesore të përditshme në Shqipëri së bashku nuk i kalojnë 30 mijë kopje duket se ka një lidhje të fortë mes mesazhit politik të përçuar përmes editorialit të lexuesi dhe sjelljes së tij ndaj këtij mesazhi. Lexuesi vazhdonte të mbante të njëjtën sjellje për një kohë të gjatë me gazetën. Botuesi dhe të besuarit e tij për shkrimin e editorialeve vazhdonin të shkruanin për lexuesit, duke u sjellë analizë të fakteve e të dukurive të realitetit objektiv, përmes shpjegimit, vlerësimit e qëndrimit që mbahet për ta: përmes argumentimit të tezave¹⁴ Për rrjedhim siç do ta përcaktonte Boriçi, "... editoriali ndikon shumë në krijimin e një opinioni të caktuar publik, në lëvizjen, zhvillimin e mendimit dhe të veprimit shoqëror"¹⁵

Lidhja Editorial-Kryeartikull

Editorialet e KJ-se ishin kundër partisë që ishte në pushtet dhe liderit të saj, Berisha. Ato kishin lidhje me kryeartikujt, të cilët shpjegojnë situatën ku ndodhet vendi.

Disa shembuj kryeartikujsh janë: "Vetëm 60% për Popullin/VEFA, Kamberi, Silva dhe Cenaj ulin interesat në 3%. Qeveria cakton kriteret për dhënien e parave të Popullit. Xhaferrri 170mln dollarë për 1.2 milionë mandate", "Gjallica vdes. Xhaferrri 52%/Qeveria premton vetëm 52% për 210 mijë klientët e Xhaferrit/Sali Berisha shpall falimentin e Gjallicës. Arrestohet Fitim Gërzhalliu. Ushtria pushton Vlorën", "Nesër:Tirana në miting/40 mijë vlonjatë ngrenë flamurin kundër Berishës/Opozita thërret banorët e kryeqytetit në shëshin "Skënderbej" në ora 12", "Vlora:Berisha në det/Vetëm 4 mijë

¹³Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimit publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.209

¹⁴ Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimit publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.207

¹⁵ Hamit Boriçi, *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimit publicistik*, Tiranë, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004, Fq.208

kreditorë marrin paratë e Popullit dhe Xhaferrit/30 mijë vlonjatë protestojnë gjatë gjithë dotës.Policia qëllon me armë 20 të plagosur", "Sot Tirana si Vlora", "Tirana shtyp Tiranën/Kastriot Islami rrihet barbarisht. Nano:Të vazhdojnë protestat/ Mijëra policë she Shikas bllokojnë dhe rrahin mijëra protestues. Opozita në qeli", "Meksi:Gati për luftë civile/Ditari I Kadrisë.Gjallica, edhe 100 mijë USD të tjera për PD/Deklaratë e papërgjegjshme e kryeministrit.Opozita I shkruan ambasadave", "VEFA, piramida po shembet". "SHBA:Duhen zgjedhje të reja", "Shkodra në Vlorë.50 mijë në shesh. Presidenti me helicopter në Gjirokastër.Tepelena bllokon truprojat.Gjimnazistët e Tiranës në rrugë", "Vlora mbytet në gjak/Mbrëmë SHIK-u ndërhyr për të rrëmbyer studentët e urisë".

Në një rast editoriali së bashku me kryeartikullin është firmosur K.J: "Europë:Shqipëri në gropë/ studentët e Tiranës bojkotojnë mësimin. Forumi: Jo mandatit Nr.2 të Berishës/ MI: BE tëriqet nga kërkesa për zgjedhje të reja. Apel për dialog. Në pikëpyetje ndihmat".

Titujt e kryeartikujve përveç notave reale të përshkrimimit të asaj që ndodhte kanë edhe dimensionin figurativ. Kryeartikujt që e konfirmojnë janë ato të datës 12 dhe 13 shkurt: "Meksi 'mbytet' në Vlorë" dhe "Doktor, shko tek Doktor". Shembuj të tjerë janë:" 'Shqiponjës i bien pendët/11 deputetë anglezë kërkojnë hetim për Berishën/Shtypi anglez etiketon si gangster qeverinë shqiptare. "Shqiponja" e PD armë dhe drogë"¹⁶ "Me presh në shesh" ¹⁷ "Zilja:Këmbanat e Meksit",¹⁸ "Lushnja fishkëllen Berishën"¹⁹ "Berisha "zgjidhet" nga zinxhirët", "Evropë: Shqipëri në gropë", "Berisha Nr.1:Të hënën bëhet nr.2".

Përmbajtja e Editorialit

Titujt e editorialeve janë të shkurtër, si: "Piramidat e harruara", "Koha Jonë" në burg", "Tani koha për politikë", "Pse nuk po çahet blloku?",

¹⁶ "Koha Jonë", 15 shkurt 1997

¹⁷ "Koha Jonë", 16 shkurt 1997

¹⁸ "Koha Jonë", 18 shkurt 1997

¹⁹ "Koha Jonë", 19 shkurt 1997

“Mbroni gazetarët nga shteti”, “2 Prilli i PD-së”, “Doktor, ky është fundi!”, “Qeveria jashtë globit”, “Ruaj paqen o shtet” etj. Trajtojnë problemet politike.

Fjalitë janë goditëse. Te editoriali: “2 Prilli i PD-së” shkruhet se regjimi i Berishës i ka lyer duart me gjak: “...Pavarësisht nga rrethanat, regjimi i Berishës, ka lyer duart me gjak. Viktimat e ditës së djeshme, mund të quhen viktima të dyfishta të pushtetit, i cili një herë u grabiti kursimet dhe më pas jetën”²⁰.

Kurse te editoriali i datës 13 shkurt i bëhet thirrje Berishës që të reflektojë se po “i vjen fundi. “...Qëndrimi në këmbë i një qeverie me një bilanc të tillë mbi shpinë i jep të drejtën morale opozitës të kërkojë hapjen e kartelave mjekësore të atyre që drejtojnë tani partinë në pushtet, përfshirë presidentin dhe kryeministrin. Zëra brenda PD kanë deklaruar së fundi se Berisha mund të ketë probleme shëndetësore”²¹.

Madje në një editorial tjetër të Frrok Çupit shkruhet edhe se “qeveria Berisha është neveritur”: “Ku qëndron kjo qeveri? Në mbarë globin tani u mbyll cikli i diskretimitit dhe braktisjes. Edhe në vendin e vet Shqipëri, qeveria Berisha është neveritur”²².

Në një nga editorialet, “Koha Jonë” i drejtohet drejtpërdrejtë shtetit, duke i thënë që të ndalë dorën dhe të ftohë mendjen, duke e cilësuar një “makinë të hekurt që përpin jetë njerëzish: “..T’i lutemi shtetit, kësaj makine të hekurt që për një sekondë përpin jetë njerëzish: Ndal dorën dhe ftoh mendjen..O shtet, rri në anën e paqes dhe me kaq është e sigurtë se gjaku ndalet”²³. Një rast që tregon se gazeta nuk po luante një rol vetëm mediatik, por edhe përfaqësonte shqiptarët e revoltuar, një rol të një partie opozitare.

Editorialet janë të shkurtër, të drejtpërdrejtë dhe autorët kanë përdorur ton të ashpër. Fjalët më të përdorura janë: Shtet, politikë, fondacione, blloku blu, gjak, piramida, gazetar, protesta etj.

²⁰ “Koha Jonë”, 11 shkurt 1997

²¹ “Koha Jonë”, 13 Shkurt: “Doktor, ky është fundi!”, Skënder Minxhozi

²² “Koha Jonë”, 15 shkurt: “Qeveria jashtë globit”, Frrok Cupi

²³ “Koha Jonë”, Editorial: “Ruaj paqen o shtet” Frrok Cupi

Në pjesën e shtojcave janë disa nga editorialet e gazetës “Koha Jonë” të periudhës shkurt-mars.

Konkluzione

Editoriali në “Koha Jonë” karakterizohet gjatë periudhës shkurt-mars, nga tematikë politike, e lidhur me zhvillimet në vend. Nëpërmjet tij kërkohet që te lexuesi të shkojnë mesazhet e qarta: Ndryshim lidershipi.

Nëpërmjet editorialit kryhet komunikim politik, ku “Koha Jonë” ka marrë rolin e një partie opozitare. Lidershipi u ndërrua në Shqipëri dhe “Koha Jonë” ka qenë një nga ndikuesit te publiku.

Editoriali shënon “frontin e luftës”, duke qenë në sintezë të plotë me kryeartikujt, por me një mesazh më të fuqishëm.

Bibliografi

1. Boriçi, Hamit. *Gazetaria 2. Probleme të mjeshtërisë dhe format e pasqyrimin publicistik*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2004
2. Boriçi, Hamit, Marku, Mark. *Histori e shtypit shqiptar. Nga fillimet deri në ditët tona*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Librit Universitar, 2010
3. Fuga, Artan. *Media, politika, shoqëria (1990-2000). Ikja nga kompleksi i Rozafës*. Tiranë: Botimet Dudaj, 2008
4. Gazeta “Koha Jonë”. 2 shkurt-1 Mars 1997
5. McNair, Brian. *Hyrje në komunikimin politik*. Tiranë: UET Press, 2009
6. Tarifa, Fatos. *Paradigma e tranzicionit demokratik: “Fundi” i tranzicionit apo një tranzicion pa fund?*. Tiranë: Ombra GVG, 2009

Shtojca

2 Shkurt: “Piramidat e harruara” K.J

“Buzëqeshjet e Zotit Berisha në RTV janë drejtuar të mërkurën drejt disa dhjetra mijë depozituesve të fondacioneve Xhaferi e Populli. Sjellshëm me shtypin, sidomos me atë të huaj, kreu I shtetit ka ofruar

një skemë që nuk dihet se sa u ka pëlqyer viktimave të “bamiësisë” së general Xhaferrit dhe Bashkim Drizës. Libreza si fillim, më pas edhe paratë. Sigurisht plus interesat bankare për kohën që do rrinë mbyllur në arkën e shtetit. Berisha ka nxjerrë nga xhepi konceptin e “shpërndarjes graduale”, rezultatet e të cilit mbeten për t’u verifikuar. Ndërkohë predisenti ka heshtur për një ushtri edhe më të madhe të mashtruarish. Tani që Sudja zuri burgun dhe Grunasi u arratis, depozituesit e këtyre firmave janë më të pashpresët. Ata, së bashku me viktimat e numri biznesmenësh të vegjël të zhdukur pa lënë gjurmë, mund t’I konsiderojnë të humbura përfundimisht paratë e fituara në fajde. Nëse kësah liste do t’I shtohet dhe Gjallica, e cila ka premtuar kthimin e parane në Dt.6 shkurt, numri I klientëve të pashpresë do të ishte I frikshëm, më I madh se I atyre që morën sigurinë e kryetarit të shtetit për rikthimin e shumave. Po bëhet një zhurmë e madhe për 300 milionë dollarët e ngrira të Popullit dhe Xhaferrit. Zhurma është aq e madhe sa që duket hapur se me “boritë” festive të shpërndarjes së këtyre parave, po tentohet të mbulohet e qara e të humburve në piramidat e harruara që kanë zënë tashmë nën vete një shumë që I afrohet 500 milion dollarëve. Ndërkohë që posteri electoral I kryetarit të Bashkisë së Vlorës po bën xhiron e botës në kombet e mbarë botës, PD vazhdon të deklarojë se me përjashtim të “frigoriferizmit” të parave të dy fondacioneve nuk ka më zgjidhje për të ofruar dhe përgjegjësi për të marrë përsipër për tragjeditë e parave të shkaktuara nga kolegët e Popullit dhe Xhaferrit. Presidenti nuk harroi të përsërisë leksionin rreth “intimitetit” të fajdes, por vështirë se ky shpjegim I ka rritur pikët e tij në radhët e shqiptarëve. Të ish-klientëve të Sudes për shembull” K.J

4 shkurt: “Koha Jonë” në burg

Gazetari I “Koha Jonë” në Korçë Roland Beqiraj ndodhet prej 8 ditësh në qelitë e repartit të policisë së qytetit. Ai nuk e di ende se kush e ka ndaluar dhe pse e kanë ndaluar. Atij nuk I është dhënë asnjë shpjegim, para tij nuk është paraqitur ende prokurori për të prononcuar akuzën dhe gjykatësit për të vendosur masën e sigurimit. Gazetari mbahet në burg dhe të gjithë ata që ligjërisht I kanë në dorë çelësat e qelisë së tij ngrenë supet. Redaksia është lidhur disa herë

gjatë 7 ditëve të qëndrimit në qeli të gazetarit të Korçës dhe dje është lidhur në telefon me orikurorin dhe zv.prokurorin e rrethit si dhe zv.kryetarin e Gjykatës së Korçës. Jemi të indinjuat thellë, të fyer nga reagimi imponent që kemi marrë nga të gjithë këta funksionarë të pushtetit local dhe të drejtësisë. Këta zyrtarë frikacakë dhe servilë kanë patur për postin që mbajnë, që të luajnë me kompetencat e njëritjetrit, duke I deklaruar drejtorit të gazetës se nuk kanë marrë dijeni dhe se me çështjen duhet të jenë marrë organe të tjera. Njëlloj si puna e Sudes me Kopetentin. Zëvendësprokurori I rrethit e cila ka bërë kërkesën për arrestimin e Roland Beqirajt I ka deklaruar zëvendëskryeredaktorit të "Koha Jonë" se "unë e kam bërë lërkesën për arrestim por arrestimin e ka bërë gjykata". E pyetur se cila është akuza që rëndon mbi gazetarin, ajo është shprehur se akuza "nuk thuhet në telefon". Gazeta Koha Jonë e njih derën e qelive të këtij shteti. Atje ne kemi shkuar më shumë se njëherë, por gjithmonë I humbur ka dalë shteti.. Tani ne kërkojmë me forcë lirimin e kolegut tonë, motivin e arrestimit të të cilit e kemi marrë vesh. Sipas burimesh të sigurta brenda Gjykatës së Korçës, mësohet se Roland Beqiraj është arrestuar në bazë të një telefonate nga Tirana pas shkrimit të tij me titull "Korce, digjet porteti I Berishës". U them atyre që e kanë arrestuar gazetarin e Koha Jonë se kanë marrë një guxim shumë të madh për të cilin nesër do të përgjigjen në bazë të ligëve me të cilat hamë bukë cdo ditë. Nëse Roland Beqiraj nuk lirohet, do të jemi ne gazetarët ende të lirë të Koha Jonë që do të dalim në rrugët e Tiranës për të djegur portretet e Sali Berishës". Koha Jonë

7 shkurt: "Tani koha për politikë", Vladimir Prela

"Pas një pause të shkurtër, në mënyrë të dukshme iluzive, pakënaqësie, populli shpërtheu edhe njëherë fort, këtë herë ajo është përqëndruar në Vlorë, qyteti ku kanë filluar jetën perandoritë e fajdeve, por edhe ku tradita qytetare, pjekuria politike dhe patriotike ka rrënjë tepër të thella, lajmet që vijnë prej andej, nga shtypi I pavarur, nga reporterët e huaj dhe televizionet perendimore, tregojnë një situatë tepër të tensionuar, një pakënaqësi totale, por edhe një spontanitet total e koshient të plotë për fajtorët e kësaj situatë.

Pikërisht për këto demonstruesit e popullit të Vlorës të bindin edhe njëherë më shumë se ka ardhur koha për të mos u shtirur. Ka ardhur koha që Zoti Berisha të injorohet ekipin e tij servile, të lërë mënjanë përkatësinë partiake, të mos veprojë më si tek përralla e “mbretit lakuriq” por të marrë përgjegjësi që I takojnë kreut të një shteti demokratik, I cili mbështetet mbi parimet e tolerancës dhe dialogut. Por mbi të gjitha ka ardhur koha që opozita, e cdo krahu qoftë të marrë në dorë situatën dhe të jetë protagonist e këtij zhvillimi historic shqiptar. Asaj I duhet të kujtojë se në cdo momenë në Serbi dhe Bullgari protestat janë udhëhequr nga partitë opozitare e për pasojë ato kanë qenë të mirëorganizuara dhe me ndonjë përjashtim rastësor, paqësore. Dhe me këtë rast të mbajë shënim, pa komplekse, se në Shqipëri, ku opozita ka mbetur në hije që nga zgjedhjet e manipuluar parlamentare të 26 majit të vitit të kaluat demonstratat kanë qenë spontane dhe me mungesën e lidërshiptit të qartë politik. Pas largimit të dhunshëm të opozitës nga skena, përballë qeverisë u vu vetë populli. Për pasojë ato janë shndërruar në trazira, që në cdo moment mund të transformohen në të dhunshme, sic edhe ka ndodhur. Tanimë nuk është koha për të diskutuar nëse këto komplekse janë spontane apo të lindura nga një realitet shtypës. Në fund të fundit edhe ajo (opozita) është shqiptare. Mentaliteti I saj është koncentrat i emerësuesit të përbashkët të revoltës, frikës dhe shqetësimit popullor. Edhe ajo kërkon një frymëmarrje, një mbrojtje, një hapsirë, një mundësi më shumë, e cila nuk duhet pritur por duhet kërkuar mbi bazën e parimeve të një shoqërie dhe të një shteti demokratik. Ajo që po ndodh në Vlorë nuk do ushtarë dhe tanke, por qetësi, dialog, mirëkuptim dhe zgjidhje. Këtë zgjidhje e ka në dorë politika, e cila së pari duhet të përjashtojë parimin “ik ti nga që të zëvendësoj unë”. Shqipëria ndodhet në një moment të vështirë historic. Në mënyrë se si do të zgjidhet kjo krizë, do të ecë edhe vendi në të ardhmen, në vitet 2000” Vladimir Prela

8 Shkurt: “Pse nuk po çahet blloku?”, Frrok Cupi

“Në vitin ’91 kur kanë shkruar këtë titull për herë të marë, mendonin se ishte e fundit. Por fatkeqësisht po ndodh përsëri pata

mkë blloku po aq fatal sa edhe blloku komunist.Ndërsa atëherë në krye të bllokut ndodhej pacienti Enver Hoxha, sot ndodhet doktori Berisha...

- 1.Blloku I Berishës po reziston njësoj si Blloku I Hoxhës
- 2.Blloku Blu nuk po jep dorëheqjen"

9 Shkurt: "Mbroni gazetarët nga shteti"

"...Mbrëmë në hyrjen e banesës së Kryeredaktorit Ben Blushi është kapur një person, I cili mbante në duar dy mjete të hekurta nga ato që përdorin elektrikistët për t'u ngjitur në shtylla. Disa minuta më parë dy persona të tjerë të veshur me xhupa të zinj lëkure, kishin pyetur për adresën e shtëpisë së Ben Blushit..Tritan Shehu, Nr.Një I partisë në pushtet dhe Nr.2 I qeverisë aktuale, ka lëshuar në aktivin e PD në VL thirrjen "Poshtë Koha Jonë"... Koha Jonë apelon...Mbroni jetën e gazetarit nga dhuna e shtetit: Kjo është thirrje që ne ndajmë se duhet t'ju drejtohet..Nesër mund te jetë vonë" Koha Jonë

11 Shkurt:"2 Prilli i PD-së"

"...Pavarësisht nga rrethanat, regjimi i Berishës, ka lyer duart me gjak. Viktimat e ditës së djeshme, mund të quhen viktimat të dyfishta të pushtetit, I cili një herë u grabiti kursimet dhe më pas jetën"

13 Shkurt: "Doktor, ky është fundi!", Skënder Minxhozi

"...Qëndrimi në këmbë i një qeverie me një bilanc të tillë mbi shpinë I jep të drejtën morale opozitës të kërkojë hapjen e kartelave mjekësore të atyre që drejtojnë tani partinë në pushtet, përfshirë presidentin dhe kryeministrin. Zëra brenda PD kanë deklaruar së fundi se Berisha mund të ketë problem shëndetësore"

15 shkurt: "Qeveria jashtë globit", Frok Cupi

"Ku qëndron kjo qeveri? Në mbarë globin tani u mbyll cikli I diskretimitit dhe braktisjes.Edhe në vendin e vet Shqipëri, qeveria Berisha është neveritur"

20 Shkurt: "20 shkurti na gjeti në rrugë", Blendi Fevziu

"..E shpëtuam Tiranën nga hija makabre e Enver Hoxhës, arkitektit të së keqes por në vend të saj ju ofruam parqeve dhe trotuarëve të

Tiranës alternativën e bingove dhe kioskave. I shpëtuam njerëzit nga 80% absurd, për ta zëvendësuar atë me përrallën e fajdeve dhe makinave të fituar jo në punë, por në sportelet e fondacioneve. Bëmë divorcin me varfërinë por 6 vjet më pas e shohim veten me 1 miliardë e gjysmë dollar më të varfër”

2 shkurt: “Sa para kanë fondacionet?”

“Sa para ka në llogaritë bankare të Bashkim Drizës dhe Rrapush Xhaferrit? Aq sa për dhënë depozitat fillestare plus këstet e para, sipas dy bosëve. Aq sa për të dhënë depozitat “në mënyrë graduale me anë të librezave”, sipas presidentit dhe qeverisë. Debati rreth shumë së ngrirë në bankat e nivelit të dytë përbën ende një mister, kur nga data zyrtare e fillimit të shpërndarjes së parave kanë mbetur vetëm tre ditë. Dje presidenti I fondacionit Populli, Bashkim Driza, I ka deklaruar punonjësve të bankës që po kontrollonin dokumentacionin e tij, se në arkën e Popullit ka 20 milionë dollarë më shumë se shifra e arkëtuar nga klientët. Megjithatë sipas llogarive rezultonte që paratë të jenë mangut, Driza pretendonte të kundërtën. Ai nuk ka pranuar të firmosë në aktet përfundimtare të përlllogaritjeve. Të gjithë kujtojnë se RTV komunikoi natën e arrestimeve të bosëve shifrën 25.5 mld lekëve në kontot bankare të dy fondacioneve. Shqiptarët e shkathët tashmë në llogari e konvertuan këtë shumë në dollarë dhe doli se Populli dhe Xhaferri kishin depozituar në bankat shtetërore rreth 250 milionë dollarë amerikanë. Historia e dollarëve të fondacioneve u kthye në parzmore mbrojtëse për qeverinë, e cila pasi e hodhi në dorë këtë shumë, mori përsipër të rregullojë imazhin e prishur duke përcaktuar shpërndarje të shpejtë me anë të komisioneve që do të punonin “ditë e natë”. Por pikëpyetjet rreth këtij rasti mbeten ende të shumta. Pse Driza dhe Xhaferri u arrestuan para se komisioni I transparencës të deklaronte natyrën e fondacioneve që drejtonin? Si shpjegohet që vazhdimisht këta të fundit kanë deklaruar se I kanë paratë për të dhënë kapitalet fillestare dhe këstet? Si shpjegohet që dje Bashkim Driza ka deklaruar se ka 20 milionë dollarë më tepër se shuma e depozituar nga klientët në arkën e fondacionit të tij? Cila është vlera e objekteve që këto fondacione zotëronin dhe cili do të jetë fati I tyre? Këto pyetje nuk kanë marrë

përgjigje megjithse 5 shkurti po afron dhe të mërkurën sportelet e bankave do të mësyhen nga klientët. Mbi të gjitha qëndron varur mbi kokat e të gjithë një dileme:Çfarë do të ndodhte nëse dy shefat e fondacioneve do të ishin jashtë burgut? Sa para do të shkonin në xhepat e klientëve të tyre" K.J

Editorial: "Vefa dhe politika shqiptare" Koha Jonë

"..Një falimentim I VEFA-s do të thoshte shpërthim i kordonit të fundit të sigurisë që mban lidhur protestën popullore...Në këtë pikë të gjithë e kanë të qartë se VEFA përbën kartën që mund të përmbysë rezultatin e lojës politike.Mbetet të shihet se çfarë ngjyre do të ketë kjo kartë"

Editorial: "Ruaj paqen o shtet" Frrok Cupi

"..T'i lutemi shtetit, kësaj makine të hekurt që për një sekondë përpin jetë njerëzish: Ndal dorën dhe ftoh mendjen..O shtet, rri në anën e paqes dhe me kaq është e sigurtë se gjaku ndalet"